

Për: Qazim Elshani, Burhan Dushullovc, Bekim Ahmeti – banorë të bllokut B-2/b_07 në lagjen e Muhaxherëve.

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Informim për takimin, që do të mbahet në lidhje me komentet tuaja ndaj ‘‘Njoftimit publik’’ për ndërtimin e propozuar të investitorit ‘‘Nord Invest’’ sh.p.k, në bllokun B-2/b_07, në lagjen e Muhaxherëve.

Data: 24.05.2023

Ju informojmë se gjatë trajtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-277617/22 dt. 30.12.2022 për Kushte ndërtimore, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore dhe afariste në emër të aplikuesve, Murat Dushullovc, Ilmi Bërbatovci, Sabit Bunjaku, Sami Qukovci, Ramadan Qukovci, Nuhi Simnica, Sinan Tmava, Driton Tmava, Hajredin Simnica dhe Muzafer Simnica me investitorë ‘‘Nord Invest’’ sh.p.k, në bllokun B-2/b_07, në lagjen e Muhaxherëve, është vendosur ‘‘Njoftimi Publik’’ prej 15.04.2023 deri më 29.04.2023 ashtu që banorët e lagjes të njoftohen për ndërtimin e propozuar. Gjatë kësaj periudhe në E-mail adresën e kësaj Drejtorie kanë arritur disa komente nga pronarët e parcelave fqinje, andaj do ta organizojmë një takim ku jeni të ftuar ju, investitori dhe projektuesit për të prezantuar zgjidhjen urbane.

Takimi do të mbahet me datë **29.05.2023** në ora **10:00h**, në zyrën nr.308 të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, rr.‘‘Radovan Zogoviq’’nr.1, lagjja ‘‘Arbëria 3’’,